



Forumi për Iniciativa Qytetare



Raport vjetor 2009



Për FIQ-in

FIQ është organizatë joqeveritare e përqendruar në sundimin e ligjit që punon për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendim-marrëse, për një rajon ballkanik të zhvilluar ku mbretëron paqa dhe drejtësia.

FIQ angazhohet për transparencën dhe llogaridhënien e qeverisë dhe forcimin e kapacitetit të shoqërisë civile për të qenë akterë aktiv dhe i qëndrueshëm në ushtrimin e rolit të vet mbikqyrës.

FIQ e bënë këtë përmes studimeve dhe analizave, diskutimeve, trajnimit dhe dhënies së granteve.

Letër nga Drejtori Ekzekutiv

Të nderuar miqë dhe kolegë,

Është kënaqësi e madhe për mua të reflektoj në punën e suksesshme të FIQ-it për këtë vit. Duke kombinuar projektet avokuese, punën me qytetarë, duke mbikqyrë dhe matur efikasitetin dhe përgjegjësinë e administratës publike dhe duke studiuar veprimet institucionale në rrugën tonë drejt Evropës, ne vumë në jetë synimet tona për të qenë zë kritik dhe partner korrekt në zhvillimin institucional dhe shoqëror, në përpjekjet e përbashkëta për një shtet më funksional. FIQ në rrugën e vet të rritës, por edhe transformimit, ndau dy grante për të mbështetur nismat ekologjike dhe pjesëmarrjen qytetare në procesin zgjedhor.

Ndarja e çmimit FIDES për Filantropinë Korporative 2009, ishte ngjarje e veçantë dhe historike që përmbylli vitin tonë të punës, duke vendosur kështu, atë që ne e quajtmë, sistem i ri i mirënjohjes dhe falënderimit për ata që kanë dedikuar ndihmën dhe përkrahjen për të mirën e përbashkët të këtij vendi.

Sikur edhe viteve tjera, ne arritëm të zhvillojmë projekte dhe aktivitete me organizatat partnere në qendra të ndryshme të vendit, duke dëshmuar edhe mëtej partneritetin dhe qasjen e të punuarit bashkë. FIQ ishte pjesë e zërit kritik të OJQ-ve për çështje me rëndësi, të cilat u ndërmorën si përgjigje ndaj politikave të gabuara dhe të dëmshme për Kosovën. Jashtë planifikimeve tona



të punës, ne mbajtëm kontaktet me komunitetet ku kishim punuar më parë dhe ndjehemi krenarë që patëm mundësi që disa prej tyre t'i mbështesim në kërkesat e tyre karshi institucioneve që nuk mbajtën në vëmendje nevojat dhe prioritetet e qytetarëve. Ne vazhduam nxitjen e debatit për çështje të sigurisë, ashtu sikur më parë që ofruam kapacitetet tona në hartimin e dokumenteve strategjike dhe ligjore në këtë fushë.

Dëshiroj t'i falënderoj të gjithë ata me të cilët vazhduam të punojmë, duke qenë kështu pjesë e ndërtimit të asaj që i shërben përgjegjësisë institucionale dhe aktivizmit qytetar.

Faleminderit të dashur donatorë që vazhdoni të mbështesni FIQ që të vë në jetë misionin e vet!

Sinqerisht,

Ferdinand Nikolla

I. SUNDIMI I LIGJIT



Në kuadër të këtij programi, i cili synon të rrisë rolin e shoqërisë civile në mbikqyrjen e institucioneve të sundimit të ligjit, për t'i bërë ato më efektive dhe më llogaridhënëse kundrejt qytetarëve, ju më poshtë mund të lexoni aktivitetet ndër më të rëndësishmet gjatë këtij viti:

Siguria në shkollat e Kaçanikut dhe Han të Elezit

Përmirësimi i sigurisë në shkolla dhe forcimi i ndjenjës së pronësisë qytetare për zgjidhjen e problemeve të sigurisë dhe për të krijuar një mjedis më të sigurt e një sistem më efektiv arsimor, vazhdon të zë një pjesë shumë të rëndësishme të fushëveprimtarisë sonë.

Që nga viti 2005, FIQ ka zhvilluar projekte për përmirësimin e kushteve të sigurisë në shkollat e Prishtinës, Ferizajt dhe Gjilanit. Strategji shumë e rëndësishme në përmirësimin e sigurisë në këto shkolla ka qenë dhe mbetet funksionimi i duhur i Këshillit të Shkollës, si dhe strukturave tjera të rëndësishme si: prindërit, mësimdhënësit, drejtorët e shkollave, policia, drejtoritë e arimit, OJQ-të dhe organet tjera përgjegjëse komunale.

Shkelja e rregullave në shkollë, ngacmimi, rrahjet, prania e armëve të ftohta, por edhe earmëve të zjarrit vazhdojnë

të jenë të pranishme në shkollat tona në Republikën e Kosovës. Analizat kanë treguar se kryesisht e këtyre veprave janë kryesisht të rinj nën moshën 20 vjeçare. Fakti se ky fenomen është i pranishëm jo vetëm në shkollat e mesme, por edhe në ato fillore, është alarmues. Problemi i dhunës, mungesa e reagimit të integruar apo strategjisë shtetërore, gjendja socio-ekonomike, problemet familjare vazhdojnë të jenë problemet të cilat ende nuk janë zgjidhur, edhe pse shumë institucione përfshirë edhe OJQ-të, dhe aktivistë të tjerë janë përpjekur të trajtojnë këtë çështje.

Gjatë muajve shkurt - nëntor 2009, mbështetur nga Caritas Luxembourg, FIQ në bashkëpunim me Këshillat e Nxënësve të gjimnazit "Skenderbeu" në Kaçanik dhe gjimnazit "Dardania" në Han të Elezit, është angazhuar në adresimin e problemeve të sigurisë në shkolla dhe ka arritur të zgjidhë disa nga problemet kryesore që janë identifikuar nga Këshillat e Nxënësve dhe përfaqësuesit e komunitetit të këtyre dy komunave. Ndër tjerash, FIQ në këto shkolla kishte adresuar problemin e mungesës së disiplinës dhe sigurisë brenda/jashtë shkollës, si dhe mungesën e një mjedisi të jashtëm relaksues për nxënësit.

Mosrespektimi i udhëzimit administrativ për masat disiplinore në shkollë

“Kodi i Mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënësit e shkollave të mesme” është një udhëzim administrativ i nxjerrë nga Ministria e Arsimit (MASHT) për së dyti herë në pranverë të këtij viti (2009). Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë të drejtat, obligimet, veprimet e ndaluara, vijueshmërinë në mësim dhe masat e procedurat disiplinore dhe zbatimin e tyre ndaj nxënësve të cilët i shkelin rregullat e kodit të mirësjelljes. Është vërejtur qartë se ky dokument nuk gjen zbatueshmëri as për së afërmi në këto shkolla, prandaj me kërkesë të nxënësve ky dokument, i cili është futur në kornizë dhe është vendosur në muret e klasëve dhe korridoret e shkollës, është diskutuar gjerë e gjatë mes nxënësve, prindërve, mësimdhënësve, drejtorëve dhe të gjithë përfaqësuesëve kompetent institucional për të identifikuar shkaqet e mosrespektimit të këtij kodi, për të mundësuar propozimet për përmirësimin e situatës. Si rezultat i këtyre diskutimeve ka dalë që shkollat duhet të ofrojnë punë aktive të Këshillit të Shkollës dhe mekanizmave tjerë në mënyrë që të mundësohet zbatimi i plotë i “Kodit të Mirësjelljes”. Ato duhet poashtu të krijojnë kushte për kultivimin e kulturës së debatit ndërmjet mësimdhënësve dhe nxënësve, i cili duket të jetë shumë pak i zhvilluar

Vendosja e ulëseve në oborre të shkollave

Me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve tjera dhe kërkesave eventuale që do të dilnin nga puna e përbashkët në këto shkolla, FIQ kishte alokuar edhe një fond të vogël, i cili nga këto shkolla u përdor për blerjen e ulëseve për nxënësit, të cilat u vendosën në oborret e shkollave. Kështu, u blenë nga 13 ulëse për dy shkollat në Kaçanik dhe 11 të tjera për gjimnazin në Han të Elezit.



Llogaridhënia e institucioneve demokratike ndaj shoqërisë civile në Kosovë

Gjatë periudhës tetor 2008 - shtator 2009 financuar nga National Endowment for Democracy (NED), u zbatua projekti i cili kishte për qëllim promovimin e përgjegjshmërisë dhe efikasitetit të institucioneve demokratike në Kosovë, dhe fuqizimin e kapacitetit mbikqyrës nga shoqëria civile. Projekti u zhvillua në Pejë, Gjakovë, Prizren, Graçanicë. Organizatat partnere pjesë të këtij projekti ishin: Syri i Vizionit në Pejë, Qendra për



Zhvillimin e Komunitetit të Biznesit (CBDC) në Gjakovë, Komunikimi për Zhvillim të Shoqërisë (CSD) në Graçanicë, Këshilli për Paqe dhe të Drejta të Njeriut (PHRC) në Prizren.

Projekti synoi të masë përgjegjshmërinë dhe efikasitetin e institucioneve të vendit, duke regjistruar kështu përvojat e qytetarëve me institucionet lokale, në mënyrë që këto përvoja/rezultate të ndahen me publikun e gjerë dhe vet institucionet, në mënyrë që këto të fundit të rrisin llogaridhënien dhe përmirësojnë shërbimet ndaj qytetarëve.

Në raportin që u publikua në fund të projektit, të gjeturat kryesore ndër tjerash ishin:

Secili qytetar që ka pohuar se ka pasur apo ka ndonjë problem në një institucion, po ashtu ka pohuar se njeh edhe të tjerë të afërm, të cilët kanë probleme të ndryshme, duke treguar kështu një matës në nivel të lartë të përshtypjeve të përgjithshme qytetare për vështirësitë e të pranuarit të shërbimeve në institucionet publike.

Qytetarët kanë përmendur mungesën e vullnetit të zyrtarëve për të shërbyer me përgjegjësi, korrupsionin dhe tendencën gjithnjë në rritje për të instaluar dhënien e mitos edhe për kryerjen e shërbimeve të vogla, ikjen nga përgjegjësia dhe detyrat e tyre, duke krijuar shpesh hamendje për qytetarët e painformuar për procedurat rreth një shërbimi.

Shumë qytetarë kanë përmendur institucionin e Komunës si shkaktarin kryesor të problemeve të tyre. Ata kanë përmendur problemet që kanë pasur me administratën komunale, por edhe kanë shfaqur në këtë prizëm brengat e tyre të infrastrukturës në vendbanimet e tyre. Ndonëse nuk ka pasur anketim kuantitativ në këtë projekt, nga intervistat e bëra, institucionet ku qytetarët kanë më së shumti probleme janë radhitur kështu: Shërbimi Civil, KEK, Policia, Komuna, Gjykata, e të tjera.

Vendi i sigurtë

FIQ dhe Saferworld, dy organizata partnere që nga viti 2005 edhe këtë vit vazhduan me projektin e vet në sferën e sigurisë. Ky projekt ka për qëllim nxitjen e kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta dhe krijimin e komuniteteve më të sigurta në Kosovë. Ky projekt zhvillohet në Kosovë që nga viti 2006 dhe në vazhdimësi është i mbështetur financiarisht nga Qeveria e Gjermane dhe ajo e Mbretërisë së Bashkuar.

Promovimi i vetëdijes publike dhe debati mbi zbatimin e Ligjit për Armët

Gjatë 10 - 23 dhjetor, FIQ dhe shumë organizata partnere si: Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar (KCIC), Këshilli për Paqe dhe të Drejta të Njeriut (PHRC), dhe Iniciativën për Progres (INPO), dhe në bashkërendim me Departamentin për Siguri Publike (DSP) të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), Saferworld organizoi debate të veçanta për të informuar dhe për të diskutuar zbatimin e Ligjit të ri mbi Armët në komunat: Gjilan, Prishtinë, Prizren dhe Ferizaj.

Pjesëmarrësit përfshinin përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), Forcës të Sigurisë së Kosovës (FSK), Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme dhe Siguri, Policisë së Kosovës, Policisë së EULEX-it, KFOR-it, ICO, UNDP, OSBE, ICITAP, pushtetit lokal, Gjykatave Komunale dhe të Qarkut dhe Prokurorisë, Shërbimi Korrektues, Qendra e Paraburgimit, Federata e Gjahtarëve të Kosovës dhe shoqatave të gjuetisë, OJQ, përfaqësues të komunitetit dhe përfaqësues të medieeve (TV Tema, TV Liria, TV Festina, TV Prizreni, TV Besa, TV Men, TV Vali, Radio Theranda, Radio Deutsche Welle, gazeta Koha Ditore, Express, Zëri dhe Kosova Sot).

Këto ishin debate të transmetuara direkt në të cilat pjesëmarrësit shprehën pikëpamje të ndryshme dhe përvoja në një varg çështjesh të ndërlidhura, siç janë numri i armëve të lehta në posedim të paligjshëm dhe praktikata e konfiskimit, duke përfshirë statistikën zyrtare për dorëzimin vullnetar dhe statistikën për viktimat nga përdorimi i armëve të lehta që nga viti 2000. Debati gjithashtu shtroi çështjen nëse prania e armëve të lehta është një pasojë e luftës në Kosovë apo traditë sajkulturore, në të cilin u debatua edhe për gjuetinë e

paligjshme dhe të papërgjegjshme dhe pyetjet se çfarë ndërhyrje është duke u zhvilluar nga ana e policisë në rastet e të shtënave gjatë festave. Interes iu kushtua edhe temës së tregut të paligjshëm, si pasojë e mangësive të gjetura në rregulloret e UNMIK-ut, dhe zbatimin e rregulloreve të UNMIK-ut mbi ndjekje penale nga ana e gjykatave.

Ndarja e mësimëve dhe përvojave mbi Sigurinë e Komunitetit me komunitetet fqinje

FIQ dhe Saferworld në bashkëpunim me OJQ Syri Vizionit, Këshillin për Paqe dhe të Drejta të Njeriut (PHRC) gjatë periudhës 4 - 9 dhjetor organizuan tryeza të rrumbullakëta në mes të përfaqësuesve të fshatrave Raushiq dhe Lubinje, me të cilët FIQ dhe Saferworld kanë punuar dhe komunitetet e tyre fqinje. Qëllimi ishte që të ndajnë mësimet dhe përvojat, dhe të paraqesin të mirat e angazhimit të komunitetit në përmirësimin e sigurisë në fshatrat e tyre përkatëse. Pjesëmarrësit përfshinin përfaqësues të fshatrave fqinje, Njësitit Policor në Komunitet të Policisë së Kosovës, OJQ-të, pushtetit lokal, me mbulesë poashtu nga mediet lokale.



Përfaqësuesit nga Raushiqi dhe Lubinja paraqitën shkurtimisht përvojat e tyre dhe proceset dhe parimet që i dhanë formë atyre përvojave. Prezantimet u pasuan nga një grup pune i cili kishte për qëllim për të demonstruar se si zhvillohet procesi i identifikimit dhe vënien e prioriteteve të çështjeve të sigurisë, dhe mënyra se si grupet e interesit dhe institucionet përgjegjëse janë të identifikuar dhe duhet të përfshihen kur është fjala për zgjidhjen e prioriteteve në nivel lokal.

Si rezultat i kësaj, pjesëmarrësit në Prizren votuan në favor të zgjedhjes së një këshilli që do të përfaqësojë fshatrat e Zhupës, të cilët ishin të gatshëm për të bashkëpunuar me të gjithë aktorët dhe institucionet përgjegjëse. Pjesëmarrësit kërkuan nga Saferworld, FIQ dhe PHRC për t'i mbështetur ata në këtë iniciativë dhe në koordinim të ardhshëm me institucionet lokale dhe qendrore.

Tryeza të rrumbullakta mbi Sigurinë në Komunitet - aktorët, mundësitë dhe sfidat

Me datë 19 dhe 21 dhjetor, FIQ dhe Saferworld, në bashkëpunim me Iniciativën për Progres (INPO), organizuan në komunën e Shtimes dhe Kaçanikut, tryeza të rrumbullakëta mbi Sigurinë në Komunitet. Pjesëmarrës ishin kryetari i komunës së Shtimes dhe një zëdhënës i komunës, përfaqësues të Këshillave Komunale për Siguri në Komunitet (KKSB), Ekipet e Veprimt të Sigurisë në Komunitet (EVS), Njësitë Policore të Komunitetit nga Policia e Kosovës, OJQ, përfaqësues të fshatit, udhëheqësit fetarë dhe medie kombëtare e lokale

Prezantimet nga FIQ dhe Saferworld mbi përvojave e tyre me temën e sigurisë në komunitet, duke përfshirë perceptimet e qytetarëve për sigurinë në komunitet dhe analiza krahasuese nga sondazhet, u pasuan nga diskutime interaktive dhe të frytshme.

Në mesin e çështjeve kyçe të diskutuara në Kaçanik ishin roli i KKSB-ve, roli i shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë, si dhe mungesa e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve institucionalë. Në përgjithësi, është ardhur në përfundim se çështja e përmirësimit të sigurisë së komunitetit kërkon angazhimin dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm në mes të gjithë aktorëve. Një nga pjesëmarrësit tha se "ne jemi shumë aktivë dhe kemi ndërmarrë një sërë nismash, por zinxhiri i bashkëpunimit është thyer, prandaj ne kemi nevojë për t'u angazhuar për më shumë bashkëpunim dhe mbështetje nga ana e qeverisë lokale".

Në Shtime, kryetari bëri një paraqitje të përgjithshme mbi punën e KKSB-së, përbërjen e saj, bashkëpunimin me aktorë të tjerë, dhe planeve të ardhshme. Njësia Policore e Komunitetit bëri një paraqitje të çështjeve të sigurisë në komunën e Shtimes. Pjesëmarrësit diskutuan për rolin e KKSB-së si dhe aktorë të tjerë, si dhe për nevojën për intensifikimin / përmirësimin e sigurisë në komunitet në përgjithësi..

Fushata në Ferizaj për siguri në komunitet

Gjatë periudhës 3 – 11 shtator 2009 FIQ, Saferworld dhe INPO, në bashkëpunim me Këshillin e Nxënësve të shkollave të mesme në Ferizajit lansuan fushatën sensibilizuese për ndikimin e dëmshëm të armëve në Kosovë, të quajtur **“Me Mençuri, Jo me allti!”** Me këtë rast u organizuan aktivitete sensibilizuese, duke përfshirë ligjërata, diskutime publike, fushatë mediale si dhe performanca simbolike lidhur me pasojat e përdorimit të armëve në shoqëri, si dhe brengat e përgjithshme të qytetarëve për sigurinë e tyre. Mjedisi shkollor si dhe brengat e nxënësve, prindërve dhe faktorëve të tjerë relevant për krijimin e një mjedisi sa më të përshtatshëm dhe të sigurtë për mësim, ishin poashtu pjesë e rëndësishme e kësaj fushate.



Monitorimi i implementimit të PVPE (Planit të Veprimit për Partneritet Evropian)

Në nëntor 2009, financuar nga National Endowment for Democracy (NED) dhe Balkan Trust for Democracy (BTD), FIQ filloi projektin me qëllim të rritjes së mbikëqyrjes publike në sundimin e ligjit. Përfshirja e shoqërisë civile dhe parlamentit në mbikëqyrje është qëllimi kryesor i projektit.



Brenda fushës së sundimit të ligjit projekti përqëndrohet në siguri (anti-trafikim, dogana, dhe polici) dhe drejtësi (funksionimi i Zyrave Ndërlidhëse të Gjykatave, bashkëpunimi regjional në drejtësi, dhe reformimi i sistemit gjyqësor), tema këto ku përqëndrohet Planit për Veprim për Partneritet Evropian (PVPE).

Ndër partnerët e FIQ-it në këtë projekt janë edhe: Instituti i Kosovës për Drejtësi (KLI)/Prishtinë, Iniciativa për Progres (INPO)/Ferizaj, Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar (KCIC)/Gjilan, Akademia për Trajnim dhe Asistencë Teknike (ATTA)/Prizren, Zhvillimi i Komunitetit Mitrovica (CBM)/Mitrovicë, Qendra për Zhvillimin e Biznesit në Komunitet (CBDC)/Gjakovë, Syri i Vizionit (SiV)/Pejë.

FIQ tashmë ka vendosur bashkëpunimin me komisionin parlamentar për integritet evropian dhe së bashku janë pajtuar që të gjeturat e raportit të përdorën nga komisioni për të ushtruar kështu më efektivisht rolin mbikëqyrës që ka kundrejt institucioneve ekzekutive të qeverisë, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e EPAP-it dhe përshpejtimin e agjendës kosovare drejt rrugës së Kosovës për integritet në BE.

II. DHËNIA E GRANTEVE

Përkrahja financiare për iniciativën “E vocërr po e paqt” nga Prishtina

Gjatë dy ditëve të Festivalit të Lirisë, që u mbajt jashtë qytetit të Prishtinës, FIQ financoi iniciativën “E vocërr po e paqt” në vlerë prej 2600 euro për organizimin e një fushate edukimi për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit.

Në një tendë të madhe të dekoruar me mbishkrimin “KOPSHTI EKOLOGJIK” ku artistë të ndryshëm punuan disa skulptura të “ricikluara” me materiale plastike dhe metali, kjo iniciativë kishte paraqitur kërkesën për taksimin e qeseve të plastikës, qese këto që jepen falas në Kosovë. Disa qindra nënshkrime u mbledhën gjatë këtyre dy netëve. Atyre që nënshkruan kërkesën (peticionin) iu dha një çantë lecke me moton “Nuk jam kese e plastikës”. Disa qindra qese janë shpërndarë gjatë festivalit, dhe disa qindra mbetën për veprimtarinë e ardhshme.

Edhe pse “KOPSHTI EKOLOGJIK” ishte vetëm një pjesë e koncertit dyditor masiv, ia solli një qëllim unik dhe bindës festivalit dhe kjo ishte kujdesi për mjedisin. “KOPSHTI EKOLOGJIK” është vizituar nga qindra pjesëmarrës të festivalit, të cilët shfaqën interes dhe për lëvizjen “e gjelbërt” në Kosovë, edhe pse duken të jenë të vogla në këtë fazë.



Përkrahja e rinisë së Shtërpcës për pjesëmarrje në zgjedhjet lokale

Në nëntor 2009, FIQ ndau një grant prej 4,500 Å për OJQ-në lokale në Shtërpcë, 'Futura Plus' për të përkrahur fushatën e sensibilizimit dhe informimit me qëllim të inkurajimit të rinisë në Shtërpcë për të qenë pjesëmarrës në zgjedhjet lokale të nëntorit/dhjetorit. Përderisa shumë probleme ekonomike dhe pragmatike e ngarkojnë këtë komunë, siç janë privatizimi i papërfunduar, ndërtimet ilegale, mjedisi kërcënues dhe papunësia në shkallë të lartë, pjesa më e madhe e popullatës serbe janë të preokupuar me çështjet të përcaktimit politik si grup etnik.

III. ZHVILLIMI I FILANTROPISË dhe ÇMIMI FIDES

Ndarja e çmimit FIDES për Filantropinë më të mirë Korporative 2009 në Kosovë

Mbështetur nga fondacioni Rockefeller Brothers Fund (RBF), më 9 tetor 2009, FIQ shpalli konkursin për ndarjen e çmimit për filantropinë korporative. FIDES është çmimi i parë i këtij lloji i dhënë ndonjëherë në Kosovë dhe do të jetë tradicional. FIQ me këtë çmim ka filluar të vendosë një sistem të ri të mirënjohjes dhe falënderimit për ata që kanë dedikuar ndihmën dhe përkrahjen për të mirën e përbashkët, e që në botën e zhvilluar emërtohet filantropi.



Çmimi FIDES dhe aktiviteti ynë në zhvillimin e filantropisë në Kosovë ka për qëllim të promovojnë partneritetin dhe bashkëpunimin e vërtetë ndërmjet sektorit të biznesit dhe organizatave jo-qeveritare dhe popullatës për të bashkëpunuar kështu në përmirësimin e cilësisë së jetesës në Kosovë.



Në ceremoninë shumë ekskluzive të organizuar me 1 dhjetor për shpalljen e fituesve të çmimit FIDES, të pranishëm ishin më shumë se 200 pjesëmarrës. Ndër mysafirët special që me ca fjalë iu drejtuan të pranishmëve dhe dorëzuan çmimet tek fituesit ishin: Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu; Shefi i ICO/EUSR, Peter Feith dhe zv.shefi i misionit të Ambasadës së SHBA-ve në Kosovë, Michael Murphy. Edhe Presidenti i fondacionit Rockefeller Brothers Fund, Stephen Heintz përshëndeti të pranishmit me një fjalim rasti.



FIDES çmimin për kontribut në nivel kombëtar e fitoi kompania **Data Project Electronics** nga Prishtina, kompani kjo e cila ka përkrahur aktivitete me rëndësi shoqërore, duke filluar nga rinia, sporti, të pastrehët dhe fuqizimin e gruas në jetën shoqërore dhe publike në Kosovë.



FIDES çmimin për kontribut në nivel lokal ku vepron kompania e fitoi kompania **Sharrcem** nga Hani i Elezit, kompani kjo e cila ka kontribuar në përmirësimin e

jetesës në komunën e Hanit të Elezit dhe Kaçanikut duke mbështetur aktivitete kulturore, artin, edukimin, infrastrukturën dhe rininë.



FIDES çmimin për kontributin e medieve e fitoi RTV 21 gjegjësisht emisioni **Edhe unë jam Kosovë**, emision ky që trajton jetën e skamnorëve në Kosovë duke dhënë një shtysë të fuqishme drejt interesimit të sektorit të biznesit në dhënien e ndihmës drejt familjeve skamnore, zbutjen e varfërisë, si dhe luftën e të gjitha formave të diskriminimit.

Që nga ky vit, tradita për mirënjohjen e kontributit për filantropinë kosovare do të jetë pjesë e vlerave të shoqërisë kosovare dhe ne të gjithë së bashku mund ta bëjmë që kjo traditë të jetojë përgjithmonë. Le të jetë FIDES një nxitje, frymëzim, motiv për të shtuar kujdesin tonë për vetveten dhe të tjerët. Le të jetë FIDES një derë e hapur për të gjithë ata që duan të kontribuojnë për të mirën e përbashkët. – ishin këto fjalë me të cilat u përmbyll kjo ceremoni

Partnerët

Atta, Prizren

Communication for Social Development (CSD), Graçanicë

Community Building Mitrovica (CBM), Mitrovicë

Drejtoria e Arsimit, Ferizaj

Drejtoria e Arsimit, Gjilan

Iniciativa për Progres (INPO), Ferizaj

Këshilli i fshatit Gërmovë, Viti

Këshilli i fshatit Lubinje e Epërme, Prizren

Këshilli i fshatit Palaj, Obiliq

Këshilli i fshatit Raushiq, Pejë

Këshilli i Nxënësve (KNF), Ferizaj

Këshilli i Nxënësve (KNGJ), Gjilan

Këshilli për Paqe dhe të Drejtat e Njeriut (PHRC), Prizren

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Minoriteteve, Obiliq

Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar (KCIC), Gjilan

Qendra për Zhvillimin e Komunitetit të Biznesit (CBDC), Gjakovë

Rrjeti Rinor i Gjilanit (RrRGJ), Gjilan

Saferworld, Londër

Syri i Vizionit (SiV), Pejë

Donatorët

Balkan Trust for Democracy (BTD)

Caritas Luxembourg

National Endowment for Democracy (NED)

Rockefeller Brothers Fund (RBF)

Saferworld

Pasqyra financiare e Auditimit



Forumi për Iniciativa Qytetare Prishtinë, Kosovë

Raporti i Auditorit të Pavarur

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Forunit për Iniciativa Qytetare ("FIQ") për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009. Llogaridhënia për fondet është përgjegjësi e menaxhmentit të Forunit për Iniciativa Qytetare. Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këtë deklaratë për pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin tonë.

Përveç siç diskutohet në paragrafet vijuese, ne kemi kryer auditimin tonë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet e Qeverisë së SHBA-ve të lëshuar nga Auditori Gjeneral i Shteteve të Bashkuara, si dhe në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Këto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të siguruar në masë të mjaftueshme se raportimi financiar nuk përmban deklaratë të gabuar financiare. Auditimi, poashtu përfshin ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe informacionet në deklaratën e përgjegjësive të fondit. Auditimi përfshin gjithashtu vlerësimin e parimeve të kontabilitetit dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare. Ne besojmë se auditimi ynë ofron baza të arsyeshme për opinionin tonë.

Sipas mendimit tonë, përgjegjshmërisë së fondi deklaratën e përmendur më lart paraqet në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, të ardhurat e programit, shpenzimet e bëra për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009 në përputhje me bazat e kontabilitetit të përshkruara në Shënimin 2.

Ky raport ka për qëllim për informimin e menaxhimit i FIQ-it dhe donatorë të FIQ-it. Megjithatë, me lirin nga FIQ-it, ky raport është çështje e të dhënave publike dhe shpërndarjen e saj nuk është i kufizuar.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare në deklaratën e përmendur më lart paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, të ardhurat e programit, shpenzimet e bëra për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009 në përputhje me bazat e kontabilitetit të përshkruara në Shënimin 2.



Stafi

Ferdinand Nikolla
Drejtor ekzekutiv

Katrien Leemen
Drejtoreshë e programeve

Nazim Haliti
Menaxher i programit

Albert Jusufi
Menaxher i programit

Valdrin Grainca
Menaxher i projektit

Sefë Govori
Menagjer i financave

Nita Luzha
Zyrtare për fonde dhe komunikim

Ardiana Basha
Zyrtare e administratës

Anëtarë tjerë të stafit që kanë punuar gjatë vitit 2009:
Nora Zejnullahu, Petrit Zogaj, Ramadan Ilazi, Mexhide Demolli, Bardha Gashi, Mrika Limani

